

URDHËR
Nr. 1009, datë 28.6.2022

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të shkronjës “P”, të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”; të neneve 28, 29 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor për Ministrinë e Mbrojtjes, zëvendësministrit të Mbrojtjes, znj. Dallëndyshe Bici.
 2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga zëvendësministri i Mbrojtjes menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij urdhri.
 3. Zëvendësministri i Mbrojtjes nuk mund të nëndelegojë këto kompetenca.
 4. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit, si dhe me pushimin e ekzistencës së organit delegues apo të deleguar.
 5. Urdhri nr. 373, datë 29.3.2022, “Për delegim kompetencash”, shfuqizohet.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MBROJTJES
Niko Peleshi